



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

---

## **Raporti vjetor i Zyres për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim**

---

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyres për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim (ZMPI)**

- Merr pjesë në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës, brenda dhe jashtë Komunës;
- Përcjellë mbledhjet e Këshillit të drejtorëve, të komiteteve dhe të Kuvendit të Komunës;
- Koordinon ndërlidhjen me shtypin, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive dhe zyrave të tjera;
- Koordinon zhvillimin dhe zbatimin e akteve komunale për komunikim me publikun;
- Ofron informacione dhe informata për politikat e zhvillimit të Komunës;
- Mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë për komunikim me qytetarë dhe administron Kodin e mirësjelljes së zyrtarëve për komunikim, për të mbajtur standarde të larta etike për zyrtarët për komunikim;
- Siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtorëve të administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe medieve;
- Informon publikun për vendimet që merr Kuvendi, me anë të konferencave dhe lëshimit të kumtesave për shtyp;

- Mban lidhje me shtypin lokal dhe mediat elektronike për çështjet që iu takojnë organeve të Komunës;
- Siguron informacione brenda Komunës dhe është në bashkëpunim të përhershëm me drejtorët e drejtorive dhe shërbyesit civilë të punësuar në drejtoritë e administratës;
- Shoqëron përfaqësuesit të mediave brenda Komunës dhe regjistron deklaratat e zyrtarëve komunalë dhënë përfaqësuesve të mediave;
- Përgatit fletëpalosje, broshura etj;
- Kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Podujevës dhe me rregulloret tjera.

Zyres për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim (ZMPI), përtej detyrave dhe përgjegjësi të lartëcekura, në baza të rregullta merret edhe me aspekte dhe forma të tjera të komunikimit siç është ajo përmes rrjeteve sociale.

Pra, për këtë qëllim stafi i ZMPI menaxhon edhe faqen e Komunës së Podujevës në facebook, web faqen e komunës dhe u kthen përgjigje në kohë të gjitha pyetjeve që vijnë nga media, organizata të shoqërisë civile dhe institucione tjera.

Po ashtu, kjo Zyre në bashkëpunim me zyrtarin për qasje në dokumente publike, koordinon punën dhe bashkëpunon për të kthyer përgjigje në secilën kërkesë që i adresohet Komunës së Podujevës, përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike.

Në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, ZMPI, merr pjesë edhe në organizimin e vizitave në teren, ceremonive të ndryshme të përrurimit të projekteve të komunës dhe për të gjitha këto shkruan komunikata, të përcjellura me fotografi u dërgohen mediave të shkruara dhe elektronike.

Po ashtu, varësisht nga rëndësia e projekteve, disa prej tyre paraqiten edhe me video të cilat realizohen nga stafi i Zyres, kjo bëhet edhe për aktivitete të komunës, por edhe me rastin e kampanjave të ndryshme, mesazheve të urimit dhe të tjera në të cilat përfshihen zyrtarët komunalë, qofshin ata politik, ose shërbyes civilë.

ZMPI, bazuar në rregullativën ligjore, përcjell debatet publike të cilat parashihen të mbahen gjatë një viti kalendarik. Në bashkëpunim me procesmbajtësit, mban proces dhe të njëjtat publikohen, gjithashtu për të gjitha takimet harton komunikatë përmbledhëse, e cila u përcillet mediave dhe gjithashtu postohet në faqe në facebook dhe në web.

Për çështje me rëndësi për komunën ZMPI në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit organizon edhe konferenca për media, në të cilat ftohen mediat lokale dhe nacionale dhe për të cilat, gjithmonë në fund hartohet komunikatë për media.

Në vitin 2021, për herë të parë nga Komuna e Podujevës është nënshkruar kontratë me mediumin lokal “TV LLAPI” i cili në koordinim me ZMPI përcjell aktivitetet e komunës. Në mënyrë të veçantë bashkëpunimi ynë me televizionin lokal është bërë për t’i përcjellë seancat e kuvendit dhe debatet e ndryshme publike që organizohen nga Kryetari i Komunës dhe instancat tjera komunale.

Në esencë, qëllimi i kontraktimit të këtij mediumi është që kuvendi, pra vendi ku përfaqësohen të gjithë qytetarët përmes partive politike, të transmetohet. Po ashtu edhe debatet publike ku merr pjesë kryetari i Komunës, anëtarët e ekzekutivit dhe qytetarët të jenë publike dhe të dëgjohen edhe nga publiku, duke rritur komunikimin, transparencën e komunës.

Po ashtu, si Zyre përcjellim secilin takim të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), Komitetit për Komunitete (KK) Shtabit Lokal Emergjent anti-Covid19 dhe Shtabeve tjera që janë formuar gjatë vitit, përfshirë atë për fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe për të gjitha aktivitetet e tyre, gjithmonë janë hartuar komunikata, të cila u janë përcjellur mediave dhe janë postuar në web dhe faqe në facebook

Me fjalë të tjera, ZMPI gjatë gjithë angazhimit të saj, përveç që zbaton detyrat brenda përgjegjësisë dhe fushëveprimit që ka, angazhohet edhe në secilin aspekt tjetër të komunikimit me qëllimin e vëtëm që qytetarët, mediat dhe institucionet që monitorojnë punën e komunës të jenë të informuara në kohë për të gjitha zhvillimet që ndodhin brenda administratës komunale.

Për këtë qëllim është publik numri i zyres dhe email adresa [infopodujeva@rks-gov.net](mailto:infopodujeva@rks-gov.net) në të cilat nga organizata të ndryshme, media dhe qytetarë vijnë thirrje dhe emaila në të cilat përgjigjemi në kohë sa më të shpejtë.

Zyrtarët e ZMPI gjatë këtij viti në vazhdimësi kanë ndjekur trajnime, me qëllim të rritjes së kapaciteteve dhe njohurive të reja, sidomos në fushën e transparencës me qëllim që ato të përdoren e praktikohen për përmirësimin e mëtejshëm të raportit të komunikimit komunë – qytetarë.

Trajtim të veçantë gjithmonë u kushtohet njoftimeve publike, të cilat përveç që shpërndahen në web dhe facebook, ato i vendosim edhe në tabela në qytet dhe në bashkësitë lokale, Orllan, Lluzhan dhe Kërpimeh me qëllim që njoftimet të arrijnë te secili qytetarë.

Për të qenë edhe më korrekt përmes kordinatorit të fshtrave edhe përmes telefonit njoftohen përfaqësuesit e fshatrave, gjithmonë për të marrë pjesë në diskutimet publike.

Po ashtu, edhe thirrjet e ndryshme për aplikime, subvencione dhe njoftimet tjera nga komuna publikohen dhe shpërndahen.

Për secilin aktivitet të Kryetarit të Komunës, kuvendit, ekzekutivit dhe të tjerë, përmes faqës në facebook, web dhe me email, paraprakisht njoftohen mediat e shkruara dhe qytetarët.

Raport rreth postimeve në faqen e Komunës së Podujevës;

Postime të përgjithshme – 244

Postime për Kuvendin Komunal; njoftime për seanca, postime me live, postime të KPF, mbledhje të komiteteve për komunitete, mbledhje të kuvendit - 54

Komunikata - 153

Shpërndarje në faqen e komunës nga faqja e kryetarit - 136

Raporte vjetore - 2

Konferenca – 6

